



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës

Kuvendi i Komunës

01Nr. 06-41373 2022

Klinë datë: 08/12, 2022

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Klinës, mbajtur me 21. 10. 2022, në sallën e Kuvendit, nisur nga ora 10:00.

Pjesëmarrës në mbledhje janë nënkryetarja e Komunës, zonja Marqe Selmanaj, drejtorët e drejtorive, zyrtarë të tjerë, përfaqësues të OSBE, KFOR, OJQ-ve, qytetarë dhe media të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit z. Fadil Gashi hapi mbledhjen duke përshëndettë të gjithë të pranishmit dhe duke theksuar se kryetari i Komunës mungon në këtë mbledhje pasi që është në një seminar shkencor në Shqipëri. Kryesuesi Gashi uroi drejtorin e ri të financave, z. Enver Berisha për detyrën e marr si dhe kërkoi që me një minutë heshtje të nderojmë ish asamblistin e vdekur para disa ditëve, z. Tush Dedaj.

Në vazhdim kryesuesi theksoi se me një vendim të organizatës botërore të shëndetësisë, tetori është muaji i cili i kushtohet luftës së sëmundjes së kancerit të gjirit dhe se sot ne me një fjongo në xhaketa kemi shënuar këtë ditë. Pjesë tjetër e veçantë sipas kryesuesit është që komisionet e themeluara të cilat nuk akne filluar akoma punën është mirë që të fillojnë sa më shpejt. Kryesuesi ka edhe një kërkesë për asamblistët femra që ta formojnë sa më shpejt rrjetin e asamblistëve femra. Ndërsa nga drejtori i Administratës kryesuesi kërkoj që sa më shpejt të furnizohen asamblistët me laptop. Po ashtu edhe për zyrën e prokurimit ka një kërkesë që të jenë sa më korrekt pasi që ka mungesa të furnizimit me letër dhe servisim të kompjuterëve. Prej prilli ka ndodhë që një defekt në printer të mos sanohet edhe pse është kërkuar nga zyra në fjalë që të merr masa. Kryesuesi kërkoj në fund që zyrtares për informim të ja japin sa më shpejt adresat elektronike dhe nga një fotografi pasi që duhet të bëhet përditësimi i të dhënave.

Kryesuesi theksoi në vazhdim që ka marr kërkesën nga grupi i LVV për interpelancë me kryetarin por pasi që kryetari nuk është këtu kjo interpelancë do të zhvillohet në seancën e ardhshme.

Kryesuesi në lidhje me rendin e ditës theksoi se ka një kërkesë shtesë për transfero të mjeteve që gjithsesi është në rend dite.

Për Rendin e ditës fjalën e morën"

Znj. Lirie Gashi: Të nderuar të pranishëm, të nderuar qytetarë të Klinës. Sot kam një çështje shumë të rëndësishme që dua ta ndaj me juve. Deri sot kam qenë në grupin e LVV dhe aspak nuk pendohem. Nga

ky moment deklarohej që do të jem anëtare e pavarur e Kuvendit dhe nuk do të jem anëtare e grupit të LVV. Arsyeja e vendimit tim është anashkalimi dhe mos bashkëpunimi i grupit tim aktual të LVV në Klinë. Emri im gjithmonë është anashkaluar nga çdo emërim dhe së fundmi mos ftesa në pjesëmarrje në zgjedhjet në qendrën e Klinës duke pezulluar emrin tim, emër ky që me përkrahjen e madhe qytetare jua siguroj ulëset në Kuvendin Komunal. Këto janë arsye të mjaftueshme që nga sot e tutje unë deklarohej si asambletë e pavarur duke qenë pranë qytetarit gjithmonë, në kërkesat dhe hallet e tyre.

z. Esat Raci: Përhëndetje për të gjithë. Dëshiroj dy çështje rreth rendit të ditës. 1. Kërkoj që të bëhet një zëvendësim në KPF . Bledar Berisha të zëvendësohet me një tjetër anëtar nga radhët e PDK, Emrin do ta japin në vazhdim. 2. Pse nuk është sjell raporti i komisionit për fabrikën e çimentos pasi që afati ka skaduar. A e akne nënshkruar anëtarët e atij Komisioni. 3. A është ardhur konfirmimi nga ministria përkatëse për zgjedhjen e dy anëtarëve të komisionit për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv drejtorëve në institucionet arsimore.

z. Fadil Gashi, kryesues: Fillimisht ju tregoj që duhet të sjellët emri sepse nuk mund të marrim vendim pa e sjellë propozimin. Ne e kemi ndërtuar një komision për hetimin e procedurave të dhënies së lejeve për fabrikë të çimentos por raporti nuk ka ardhur në zyrën e Kryesuesit. Për komisionin për zgjedhjen e drejtorëve dhe zv drejtorëve po ka ardhur konfirmimi i ligjshmërisë dhe jemi ok.

z. Zafer Gashi: Falënderim të veçantë nga LVV ka znj. Lirie Gashi. LVV ka statusin e vet , rregulloret e saja prandaj ne i urojmë suksese znj. Lirie si asambletë e pavarur. Sigurisht që këto lëvizje janë personale sepse gjithmonë kur kërkojmë votën nga qytetarët e kërkojmë për partinë që i përkasim, në këtë rast po shihet se ka qenë për veten e saj, ndërkohë që ne mbrojmë interesat dhe programin e partisë. Edhe një herë i dëshirojmë sukses.

Znj.Lirie Gashi: Faleminderit, dr. Gashi. Nuk është çështje individuale por është çështje parimesh. Që në fillim e thash që emri im ka qenë i anashkaluar. Edhe unë ju uroj suksese gjithashtu.

z. Zafer Gashi: Secila parti i ka rregullat e veta. PDK ka dhe i ka me të buta...

z. Valmir Bacaj: Dëshiroj të ndërlihem në dy çështje. Së pari tek KPF kërkoj që të na sjellët një interpretim ligjor sepse LVV s' ka grup Kuvendar tani dhe duhet parë se sa anëtarë i takojnë grupit tonë kuvendar. Po ashtu sa i përket komisionit e diji që është përfunduar raporti por duhet kërkuar nga kryesuesi i komisionit pse nuk an ka thirr që të nënshkruajmë raportin.

z. Fadil Gashi, kryesues: Për të gjithë ju që jeni prezant. Përfaqësimi në KP bëhet secili etnitet politik që është në kuvend edhe sikur të jetë vetëm një anëtar. Në fillim të mandatit kemi gjetur mirëkuptim edhe me grupin e AAK të cilit i ka takuar një anëtar më shumë por kemi gjetur mirëkuptim sikurse në mandatet e kaluara kur PDK-së i takonte por sikurse ju edhe ata patën lëshuar pe për një anëtar.

z. Valmir Bacaj: Ne si komision kemi përfunduar të gjitha detyrat. Kemi përfunduar të gjitha intervistat dhe kemi shqyrtuar materialin që ka të bëjë me komisionin. Kemi ardhur që të bëjmë formulimin e fundit dhe të nënshkruajmë raportin. Tani për nënshkrim të raportit nuk jemi ftuar. Ndoshta sepse nuk janë gjetur shkelje nuk e diji.

z. Fadil Gashi, kryesues: Unë e kam ftuar kryesuesin e komisionit por më ka thënë që ka pasur një rast vdekje. Është mirë që të vije sa më shpejt ai raport në Kuvend.

z. Arben Limanaj: Përshëndetje të gjithëve. Zgjedhjet që bëhen nga anëtarët e Kuvendit dhe lëvizin në grupe të tjera është zgjedhje e tyre. Por dua një sqarim nga ju kryesues, derisa është certifikuar anëtari i kuvendit si anëtar i një subjekti nuk mund ta ndryshoj subjektivitetin.

z. Fadil Gashi, kryesues: Subjektivitetin nuk mund at ndryshoj askush sepse jemi të certifikuar por nuk mund të ja ndalojmë askujt rreshtimin. Nga ne mos insistoni me jua shkruajt subjektin politik poshtë në tiketë juve që ndryshoni rreshtimin.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje të gjithëve. Urime z. Enver Berisha për postin e ri. Urime Bledarit për ardhjen në grupin e AAK-së. Gjatë mandatit të kaluar nuk akne qenë pjesë e KPF anëtarët e PSHDK, Nisma, AKR.

z. Fadil Gashi, kryesues: Me rrotacion e akne pasur. Kush është për këtë Rend të Ditës me propozimin tim për transfero të mjeteve?

Me 27 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Pika 1 e Rendit të ditës: Arsytimi i mungesave

Të gjithë anëtarët e kuvendin janë prezent

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

-Procesverbali nga mbledhja e kaluar MIRATOHET me 27 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Pika 3 e rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe aprovimi i Rekomandimeve të KPF-së

Rekomandimet që nuk ishin në rend të ditës, kryesuesi i kuvendit i lexon një nga një . U sqarua ndarja e mjeteve për zyrën për barazi gjinore nga drejtori i administratës, z. Binak Sylaj i cili tha se buxheti për këtë lëmi është i ndarë prej viti në vit dhe është i gatshëm për tu shfrytëzuar. Me 27 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA. Gjithashtu edhe kërkesat për ndihmë për dy zyrtarët e administratës, Sami Veseli dhe Nazmi Elshani , ndihmë për shërim me deklarinimin pro të të gjithë shefave të grupeve kuvendare me 27 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUAN.

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Të nderuar të pranishëm. Meqenëse është prezantimi im i parë në këtë mandat, unë shfrytëzoj rastin të ju uroj të gjithëve punë të mbarë dhe suksese. Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, kemi nxjerr shënime dhe duke u konsultuar me kryetarin dhe kryesuesin kemi vendosur që të i lirojmë dy kategori nga qiraja. E para të gjitha ato biznese që akne kontratë me Komunën të lirohen një vit e gjysmë nga obligimi i qirasë. Dhe e dyta kemi bërë lirim të një pjese nga kategoritë sociale për dy vite. Kjo edhe duke u bazuar në rekomandimin auditorit që në çfarëdo mënyre të zvogëlohen borgjet ndaj komunës. Po ashtu kërkoj që ndihma e ndarë ndaj dy punëtorëve të administratës të ketë trajtim të barabartë me ndihmën që është dhënë paraprakisht për raste të njëjta , pra të jetë 1500 euro.

Rekomandimi u nxjerr në votim(falja e obligimit të qirasë) dhe me 27 vota për , asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA. Kërkesa e z. Pjetër Beqiri nuk u votua sepse nuk i përket Kuvendit.

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi i raportit financiar për periudhën Janar-shtator 2022

z. Enver Berisha, drejtor i FEZH: Dua ta nisë në një formë më të veçantë se sa herëve të tjera që është nisur ndonjë herë. Përgjegjësinë për këtë periudhë kohore e ka bartur një person shumë profesionist e

që vdekja e tij ka lënë shumë boshllëk në këtë aspekt. I jam shumë mirënjohës z. Aziz Desku për kontributin e dhënë dhe i shprehë ngushëllime familjes dhe gjithë të afërmeve të tij. Pjesën e dytë të kësaj periudhe e ka udhëheq z. Ajet Sejdiu i cili bashkë me stafin akne arritë që ta përgatisin një raport të mirë dhe të saktë. Unë fillimisht po ju jap shifrat dhe them se buxheti deri në këtë periudhë është shpenzuar rreth 52% deri në datën kur është hartuar ky raport. Mos shfrytëzimi i më shumë buxhet për këtë periudhë ka qenë pengesa e nivelit qendror. Sa kam parë në këtë periudhë dhe vllugun e punëve besoj që do të arrijmë ta shfrytëzojmë kënaqshëm.

z. Berisha në vazhdim prezanton me shifra nëpër kategori se sa janë shfrytëzuar mjetet buxhetore.

z. Arben Limanaj, në emër të grupit të LDK kërkoj sqarime për disa shpenzime dhe rritje të tyre që krahasuar me vitet e tjera sipas z. Limanaj janë dukshëm më të mëdha. Po ashtu ai kërkoj sqarim për shpenzimet tek drejtoria e shëndetësisë për një shpenzim konkret që në vitin e kaluar ka qenë 24.375,00 ndërsa në vitin 2022 vetëm 16 euro. Po ashtu edhe tek karburantet për vetuar, vendimet e gjykatave etj. Si grup kërkoj që këto shpenzime të ulen dhe të menaxhohet më mirë paraja publike.

Po ashtu edhe z. Kushtrim Halitaj, theksoi se ka parë tek mallrat dhe shërbimet shpenzime që s' ka arit ti kuptoj sa shumë janë rritur si tek furnizim me ushqim dhe pije ku diferenca me vitin e kaluar është 40 mijë euro më shumë. Edhe tek mirëmbajtja rutinë dhe mirëmbajtje të pajisjeve dhe mobileve që është shumë më e madhe se sa vitin e kaluar për 30 mijë euro.

Z. Zafer Gashi, kishte vërejtje tek të hyrat i cili tha se shihet një rënie krahasuar me vitin e kaluar , konkretisht tek tatimi në pronë. Po ashtu tek shpenzimet brenda vendit që janë më të rritura, shërbimet e blera, karburantet për vetura të rritura, mirëmbajtja e ndërtesave që ka rritje gjithashtu. Tek Mallrat dhe shërbimet sipas z. Gashi shihet një zvogëlim për 17 mijë euro më pak, fushat sportive që tani nuk janë fare, janë zvogëluar shpenzimet për kanalizime, ujësjellës. Z. Gashi theksoi se do të duhej të kishit më shumë kujdes në atë që shkruhet.

z. Esat Raci kishte dy çështje rreth shpenzimeve për këtë periudhë duke u pajtuar plotësisht me kolegët parafoles. Ai kishte pyetje për ekzekutivin, ku tha se në bazë të të dhënave janë shpenzuar për investime kapitale vetëm rreth 20-25%, a do të arrihet 75% i shpenzimeve kapitale që të fitohet grandit qeveritar? Nëse jo kush mban përgjegjësinë për mos arritjen e këtij grandit. Po ashtu ai tha se sipas hulumtimeve të GAP, komuna e Klinës radhiten e fundit për përmbushjen e premtimeve, vetëm dy premtime janë përmbushur deri tani, tha z. Raci në fund.

z. Valmir Bacaj theksoi se shpenzimet e buxhetit deri në këtë periudhë është i kënaqshëm duke u bazuar në vështirësitë që kanë dalur nga niveli qendror. Z. Bacaj foli për shpenzimet e rritura dhe krahasoi me rritjen e çmimeve dhe konsideroj që janë rritje të arsyeshme. Për shpenzimet për shujta për arsimtarë theksoi se është një obligim që i ka mbetur komunës pa të drejt dhe se do të rregullohet në vazhdim.

z. Binak Sylaj, drejtor i Administratës u pajtua me shpjegimin e z. Bacaj duke theksuar se nuk ka ngritje por ka rritje të çmimeve që ka bërë të jetë kjo diferencë. Ai u ndal tek derivatet duke theksuar se do të duhet të shihen shpenzimet në litra e jo në euro sepse rritja e çmimit të karburanteve është pothuajse dyfish. Ndërsa shpenzimet në litra janë shumë më të vogla se sa periudha e njejt e vitit të kaluar. Duke ju lutur që në këtë mënyrë të prezantohet para publikut kjo rritje ai foli veç e veç për të gjitha shpenzimet e derivateve nëpër drejtori.

z. Zafer Gashi kërkoj që të kemi informacione se kur janë rritur çmimet e derivateve. Ndërsa z. Kushtrim Haliti kërkoj edhe një herë sqarim për shpenzimet e mirëmbajtjes rutinë.

z. Binak Sylaj morri përsëri fjalën duke theksuar se po jep sqarime sipas kërkesës për një drejtor që të kuptohet njejt edhe për drejtoritë e tjera. Ai tha se për drejtorinë e administratës në janar janë shpenzuar 48 litra karburant për një automjet e janë paguar 56 euro, në shkurt-160 litra janë paguar 199 euro, në mars nuk ka pasur shpenzime, në prill janë shpenzuar 50 litra e janë paguar 70.20 euro, në Maj – 94 litra dhe janë paguar 149.26 euro, qershor- 155 litra , janë paguar 265.43 euro, korrik – 145 litra, janë paguar 225.55 euro, në gusht-96 litra e totali në euro ka qenë 131.75 euro. Ky është tabelari në formën se si janë shpenzuar në litra dhe në euro, theksoi z. Sylaj.

Në këtë debat u përfshi edhe asamblisti Tunë Dedaj i cili theksoi se ku bëhet punë edhe shpenzohet. Ai morri shembull një inspektor i cili për me e krye punën që e ka për detyrë duhet ta përdor makinën e kësioj edhe shpenzon karburant. Ai kërkoj që të kursehet sa më shumë buxheti por assesi që në emër të kursimit të mos kryhen punët.

z. Shemsedin Berisha duke qenë drejtor i shëndetësisë në mandatin kaluar theksoi se kanë ekzistuar disa kontrata për shërbime shtëpiake që janë paguar në atë kategori. Tani arsye pse tani ka vetëm 16 euro shpenzim në atë kategori është sepse kanë skaduar kontratat dhe nuk janë bërë kontrata të reja akoma.

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizmit, theksoi se % që u tha prej 25% ka qenë një % e më hershme dhe se ai tha se tani është diku te 40% të shpenzimeve dhe se i siguron që do të kalohet 75% i shpenzimeve tek kapitalet. Sa i përket kush do ta merr përgjegjësinë, ai tha se përgjegjësia do të duhej të mbetej tek niveli qendror që në shumë projekte ka bërë pengesa.

Ne vazhdim rreth shpenzimeve në këtë pikë të rendit të ditës u inkuadrua edhe z. Enver Gashi i cili përveç fjalëve miradije kishte edhe kërkesa për reduktime të shpenzimeve nëpër kategori të ndryshme ku ndryshimi është shumë i madh krahasuar me vitin e kaluar për periudhën e njëjtë.

Në fund të këtij debati fjalën e morri drejtori i FEZH për të sqaruar dy dilema të theksuara nga asamblistët. z. Berisha foli për shujtat të cilat derivojnë nga kontrata kolektive dhe për një kategori mësimdhënësish që kanë lëndën në gjykatë për shujtat. Këta mësimdhënës ose duhet të tërhiqen nga padia në Gjykatë ose duhet pritur përfundimin e lëndës në gjykatë. Po ashtu për shpenzimin e përmendur, mirëmbajtja rutinë, ai tha se akt ë bënë me rregullimin e rrugëve me zhavorr, parqeve , shesheve etj.

Pika 5 e Rendit të Ditës: shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit në KKSB.

Kryesuesi theksoi se kërkesa ka të bëjë me zëvendësimin e priftit ortodoks, Jovan Cvetkovic me priftin ortodoks, Delibor Kojic i cili tashmë është emëruar në famullin e kishës ortodokse.

Me 25 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUAR zëvendësimi.

Pika 6 e Rendit të ditës: Kërkesa e drejtorisë së FEZH për transferimin e mjeteve nga kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime në kategorinë Shpenzime Komunale dhe transefrin e mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Paga dhe shtesa.

Me 23 vota për, 2 abstenime asnjë kundër U MIRATUA.

Pika 7 e Rendit të ditës: Pyetje dhe përgjigje.

z. Esat Raci: Kam një kërkesë për drejtoreshën e Kulturës për politiken e punësimeve. Është bërë trend kjo gjë tani më të gjithë qytetarët e Klinës po e dinë paraprakisht kush ku ka me u punësuar. Një konkurs që ka qenë në drejtorinë e Kulturës, tre veta janë punësuar. Punësohet njeri nuk e nënshkruan kontratën, punësohet i dyti ik jashtë shtetit dhe në fund punësohet i treti. D.m.th. tre veta me një konkurs. Drejtoresha nuk është këtu, kam shumë respekt për moshën e saj të re dhe angazhimin e saj, gjithsesi do të doja një përgjigje kurdo që të ketë mundësi ajo.

z. Binak Sylaj, drejtor i administratës: Për pyetjen në fjalë, procedurat i udhëheq zyra e personelit. Me aplikimin e ligjit të ri për zyrtarët publik, lista rezervë respektohet. Kjo që thotë Esati ka shkuar në këtë formë. Rrjedhja e këtij punësimi ka shkuar sipas kësaj liste. Kandidati i tretë e ka lëshuar detyrën me dëshirën e tij dhe zyra e personelit e ka ftuar kandidatin e katërt i cili ka nënshkruar por nuk është pranuar nga niveli qendror, sistemi. Deri në kthimin e përgjigjes nga niveli qendror jemi në pritje, ai kandidat akoma nuk ka nisë punën.

z. Enver Gashi: Kam një pyetje për drejtorin e Urbanizimit. A do të fillon ndërtimi i këndit të lojërave për fëmijë në Sferkë.

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit: Do të ndërtohet një park e në kuadër të atij parku prej 10 mijë euro do të ketë edhe kënd të lojërave për fëmijë.

z. Kushtrim Haliti: Unë kam dy pyetje. Për Inspektoratin. Pse i jepet leja për terasa përsëri pasi një herë nuk i është dhënë leja. Dhe e dyta për drejtorin e Urbanizimit: A paguajnë të gjithë qytetarët tatimin në pronë? Pse në lagjen mbi hekurudhë nuk keni bërë asnjë investim? Apo i keni nda këta njerëz sepse janë nga Drenica e investimet i keni quar në lugun e Drinit.

z. Faruk Smajli, drejtor i Inspektoratit: Sa i përket terasave, ne jua ndalojmë punën derisa të pajisen me leje. Sa i përket uzurpimit të parkingjeve, inspektorati shumicën i ka liruar por s'po e diji konkretisht për ku është fjala.

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit: Sa i përket investimeve rreth lagjeve të theksuara nga z. Haliti, ne kemi një projekt me mbi 300 mijë euro por ka pasur vonës nga OE e që së shpejti do të nis punimet.

z. Zafer Gashi: Unë pata një pyetje për drejtorin e Arsimit por nuk është këtu. Pranimi i mësimdhënësve në shkollën e mesme "Fehmi Agani" Degën e mjekësisë është bërë sipas procedurave ligjore. Dhe pyetja e dytë për z. Enver Berisha, drejtor i urbanizimit, a qëndroni prapa asaj që keni deklaruar rreth punimeve në hapësirën e fabrikës së çimentos së operatori ka të drejt të punoj aty pasi që policia prap ka ndërhy dhe ja ka ndaluar punimet.

z. Enver Berisha, drejtor i Urbanizimit: Nuk na takon neve që të ndërhyjmë në çështje të shpimeve që ai operator bënë atje, ajo i takon inspektoratit në nivel qendror.

z. Tunë Dedaj: Unë kam një kërkesë, në mungesë të kryetarit dhe drejtorit të SHP që të angazhohet nënkryetarja që një kompani që ka hap gropa asfalt në Ujmir tek lagja e Millakëve të shkoj brenda javës së ardhshme dhe ta rregulloj.

Znj. Blerina Berisha : Përshëndetje. Kam pyetje për dy drejtorë që nuk janë prezent. Pyetja e ime për drejtorin e shërbimeve publike është se kur do të përfundojnë punimet për ujësjellësin në fshatin Gjurgjevik i madh dhe për drejtorin e arsimit , a ka filluar shpërndarja e shujtave për nxënësit?


Znj. Lirie Gashi: Edhe unë kam pasur një pyetje për drejtorin e arsimit. Unë si kryesuese për transportin e nxënësve dua të dija se çfarë është duke ndodhur me transportin e nxënësve. Një përgjigje që më është dhënë nga drejtoria e arsimit nuk më ka pëlqyer e cila ishte se nga Janari do të nis me 50% të pagesës. E fundit u pajtova që kjo të ndodhë nga Janari.

Kryesuesi i kuvendit , z. Fadil Gashi para se të përfundoj mbledhjen theksoi se anëtarëve të kuvendit ju ka ardhur një ftesë për takim nga asociacioni i Komunave, prandaj i lutë anëtarët e kuvendit që të ju përgjigjen këtyre ftesave dhe të marrin pjesë në këto takime të ftuara.

Duke i falënderuar të gjithë për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë në këtë mbledhje të kuvendit, kryesuesi i kuvendit shpalli të mbyllur punimet e kësaj seance.

Procesmbajtës:

Skënder Behramaj



Kryesuesi:

Fadil Gashi

